



Pranuar / Dorezuar Puniljena / Prodato Received / Deliverty	03.06	2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHK	2845	2021	1/4	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.305/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- Kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani- anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.305/2021 të datës 27.04.2021 të parashtruar nga grup ankuesish të përfaqësuar nga me adresë Rruga "Haxhi Hasani", Fshati "Grabovc i Epërm" Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.06.2021, mori këtë:**

### V E N D I M

**I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e ankuesve,**

e parashtruar me ankesën me numër A.nr.305/2021 të datës 27.04.2021 nga përfaqësuesi i autorizuar

**II. SHPALLET JO KOMPETENT** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit Muhamet Preniqi e parashtruar me ankesën me numër A.nr.305/2021 të datës 27.04.2021 nga përfaqësuesi i autorizuar

### A r s y e t i m



emërimi i ankuesit

Akt emërimi i ankuesit

si dhe përgjigjia

në ankesë nga organi i punësimit më shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/44.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve të përfaqësuar nga \_\_\_\_\_ është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve të përfaqësuar nga \_\_\_\_\_ të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilët pretendojnë për kompensim të shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve të punës sipas nenit 54 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, Kolegji ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*.

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se meqenëse se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi dhe nuk është ripërtëritë asnjëherë, atëherë nga koha kur nuk është në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet asnjë lloj kompensimi sipas kësaj marrëveshje rrjedhimisht as kompensimin për shpenzimet e ushqimit për ditët e punës për nëpunësit civil sipas kësaj marrëveshje nuk mund të realizohet, mbi këtë bazë pretendimi i ankuesve është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke analizuar provat e lëndës gjegjësisht Kontratën e punës të datës 03.02.2017 me numër II/09 te ankuesit Muhamet Preniqi, i cili ka lidhur kontratë pune me Komunën e Obiliqit duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-212 të Punës dhe është i sistemuar në vendin e punës "Punëtorë Teknike në Shtëpinë e Pleqve", e cila pozitë nuk e ka statusin e shërbyesit civilë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se të punësuarit që kryejnë veprimtari ndihmës dhe të mirëmbajtjes, në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk i takojnë shërbimit civil respektivisht janë kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës ashtu siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 6 ku theksohet se: *6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.* Andaj, duke marrë parasysh se ankuesja tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit administrativo-teknik dhe mbështetës.



Ndërlidhur me këtë pjesë VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësit administrativ dhe mbështetës, ku neni 82 i këtij ligji, përcakton se: *“Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës”*, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.305/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

